

ISOMAT SL 17

Material elastomerik për hidroizolim nën pllaka

Përshkrimi

ISOMAT SL 17 është material izolues elastomerik pa tretës, i gatshëm për përdorim që zbatohet me rul. Pas mpiksjes krijon një membranë shumë elastike që është njëkohësisht edhe hermetike, edhe e përshkueshme nga avujt e ujit.

Fushat e përdorimit

ISOMAT SL 17 është ideal për hidroizolim (pa fuga dhe bashkime) të sipërfaqeve që do të shtrohen me pllaka qeramike, në mjedise me lagështi si banja, dushe etj.

I përshtatshëm për të gjitha sipërfaqet prej betoni, suvaje, pllakash gipsi, pllakash zdrukthi etj. Por nuk duhet të përdoret në mjedise ku ka gjithmonë ujë me presion.

Të dhënat teknike

Ngjyra:	gri
Densiteti: (EN ISO 2811-1)	1,44 kg/litër
Viskoziteti: (Brookfield R5/2)	85-100.000 mPa.s në +23°C
Zgjatimi deri në këputje: (EN ISO 527-3)	> 100%
Dry film thickness: (EN ISO 2808) (Wet film thickness: 1000 µm, Solid përmbajtje: 60%)	600 µm
Ngjitja: (EN 1542, kërkesë për sistemet fleksibël pa trafik: 0,8 N/mm ²)	> 2,5 N/mm ²
Reagimi ndaj zjarrit: (EN 13501-1)	Class F
Rezistenca ndaj temperaturës:	nga -15°C deri në +80°C
Rezistenca tërheqëse: (EN ISO 527)	> 3 N/mm ²
Koeficienti i depërtueshmërisë nga avulli (µ): (EN ISO 7783:2011)	19.300
Hidroizolimi: (EN BS 12390-8)	7 atm

Thithja kapilare e ujit: 0.01 Kg/m²h^{0.5}
(EN ISO 1062-3: W₃ low,
w < 0.10 Kg/m²h^{0.5})

Temperatura minimale
e përdorimit: +5°C

Koha e tharjes: ≥ 6 orë në +20°C

Koha e shkeljes: afërsisht pas 6 orësh
në +20°C

Ngjitja e pllakave: pas 6 orësh në +20°C

Udhëzimet e përdorimit

1. Nënshtrësja

Sipërfaqja duhet të jetë e pastër, pa graso, grimca të lira, pa pluhur etj. Vrimat duhet të riparohen duke përdorur stuko PLANFIX. Pas kësaj, duhet të vijojë lyerja me astarin e veçantë akrilik UNI-PRIMER, me një konsum rreth 100-200 g/m², në varësi të aftësisë thithëse të nënshtrësës.

2. Përdorimi

ISOMAT SL 17 aplikohet në 2 duar me furçë ose me rul, pasi astari të jetë tharë. Dora e dytë duhet të aplikohet pasi është tharë e para. Mund të aplikohet gjithashtu në një shtresë me një mallë të dhëmbëzuar (krehër), me madhësi të dhëmbëve prej 3-4 mm dhe të nivelohet me një mallë të lëmuar.

Kështu arrihet një trashësi uniforme e shtresës së veshjes.

Materiali hidroizolues ISOMAT SL 17 duhet të përforcohet për së gjati midis bashkimeve murdyshe me shirit rrjetë me fibër xhami (65 g/m²) ose me rrip pëlhere prej poliestre (30 g/m²).

Veglat pastrohen me ujë ndërkohë që ISOMAT SL 17 nuk është tharë ende.

Ngjitja e pllakave të qeramikës duhet të bëhet me kolë pllakash të elastifikuar duke shtuar ADIFLEX-B.

Konsumi

1,0-1,5 kg/m², në varësi të nënshtrësës.

Ambalazhimi

ISOMAT SL 17 ofrohet në kova me 5kg dhe 15kg.

ISOMAT SL 17

Magazinimi

Afati i ruajtjes për përdorim, në kova të izoluara dhe në ambiente pa ngrica, është minimumi 24 muaj.

Përbërësit organikë të avullueshëm (VOCs)

Sipas Direktivës 2004/42/KE (Shtojca II, tabela A), përmbajtja maksimale e lejuar e VOC-së për produktin e nënkategorisë “g”, lloji WB është 30 g/l (2010) për produktin e gatshëm për përdorim. Produkti i gatshëm për përdorim ISOMAT SL 17 përmban 9 g/l VOC.



2032

ISOMAT S.A.

17th km Thessaloniki – Ag. Athanasios
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag Athanasios, Greece

18

2032-CPR-10.11

DoP No.: ISOMAT SL 17 / 1441-01

EN 1504-2

Surface protection products

Coating

Permeability to CO₂: Sd > 50m

Water vapor permeability: Class I (permeable)

Capillary absorption: w < 0.1 kg/m²·h^{0.5}

Adhesion: ≥ 0.8 N/mm²

Reaction to fire: Euroclass F

Dangerous substances comply with 5.3

ISOMAT S.A.

BUILDING CHEMICALS AND MORTARS

ZYRAT QENDRORE – FABRIKA:

17th km Thessaloniki - Ag. Athanasios Road,
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece,
Tel.: +30 2310 576 000, Faks: +30 2310 722 475

www.isomat.al e-mail: info@isomat.eu